

Debat publik në temë “Pozita sociale e bashkësive etnike që nuk janë shumicë në Tetovë”

Më 18 nëntor të vitit 2008 në Tetovë u mbajt debat publik në temë “Pozita sociale e bashkësive që nuk janë shumicë në Tetovë”. Në debatin publik morën pjesë përfaqësues të vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve (3), organizatave joqeveritare (14) dhe medimeve (4) nga Tetova. Qëllimi i debatit publik ishte konstatimi i pozitës aktuale sociale të bashkësive etnike që nuk janë shumicë në Tetovë, përmirësimi i komunikimit mes palëve të prekura në bashkësinë lokale dhe inicimi i interesimit dhe informimit më të madh të qytetarëve për të drejtat e bashkësive etnike jo shumicë në sferën e të drejtave sociale. Moderator i debatit ishte Lulzim Haziri nga Asociacioni për iniciativa Demokratike nga Gostivari.

Debatin publik e hapi Hajrije Ahmed, kryetare e organizatës Vlera të Përbashkëta nga Shkupi, e cila bëri një prezantim të shkurtë të projektit.

Në vazhdim të debatit kishte disa fjalime. Arjeta Aliu nga Qendra ndërkomunale për punë sociale në Tetovë dha një pasqyrë të shkurtë të strukturës dhe punës së kësaj qendre. Adnan Nuhi, kryetar i Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në Komunën e Tetovës, informoi për punën e komisionit i cili takohet rregullisht dhe në të cilin ka 2 anëtarë shqiptarë dhe nga 1 anëtar maqedonas, turk dhe rom. Nadir Rexhepi nga Asociacioni për zhvillimin e bashkësisë rome “Sonce” theksoi se romët në Tetovë janë të përjashtuar nga proceset e aprovimit të politikave publike, kurse në qytet ekzistojnë 3 geto të komunitetit rom për të cilët komuna akoma nuk ka ndërmarrë asnjë masë. Branka Marković nga organizata joqeveritare “Sreqen zigot” foli për statusin socio-ekonomik të komunitetit serb në komunën e Tetovës dhe theksoi se në këtë moment asnjë serb nuk merr pjesë në pozitë udhëheqëse në institucionet të nivelit lokal. Nebojsa Zaharijevski nga organizata joqeveritare “Aleanca rinore” sqaroi se pas aprovimit të Marrëveshjes kornizë në komunë ka zvogëlim të numrit të punësuarve të komunitetit maqedonas, kurse komunitetit maqedonas në Tetovë ndjehet inferior kur bëhet fjalë për realizimin e të drejtave të veta.

Në vazhdim u bisedua për gjendjen e komuniteteve më të vogla nga aspekti i statusit social dhe realizimit të së drejtave për ndihmë sociale, me aksent të veçantë te romët. Sektori joqeveritar ishte i thirrur të bashkëpunon për shkak të integritetit më të shpejtë të komunitetit rom në Tetovë.

Në debatin publik u dëgjuan nevojat e bashkësive etnike jo shumicë të cilët jetojnë në Tetovë. Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se pozita sociale e bashkësive etnike që nuk janë shumicë në Tetovë paraqet një temë aktuale prandaj në periudhën në vazhdim u organizua punëtori tematike në kuadër të së cilës u përpilua plan aksionar për përmirësimin e pozitës së bashkësive etnike jo shumicë në komunën e Tetovës.

Debatin publik e organizoi Fondacioni Institut Shoqëria e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me Vlerat e përbashkëta nga Shkupi.